

Ardhmëritë e

Ndritshme

Përmbledhje ekzekutive
e strategjisë për
të rinjtë e Haringejit
të moshave 11 - 19

Ardhmëritë e Ndrishme (Bright Futures) është strategji për përmirësimin e arritjeve të të rinjve të moshave 11 – 19 vjeç në Haringej. Është organizuar rreth pesë shtyllave:

- Të Rinjtë në Haringej
- Mësimi dhe Mësimdhënia në Haringej
- Udhëheqës Haringej
- Prindër dhe Komunitet Haringej
- Shkollë Haringej

“Vizioni ynë është për shkolla të suksesshme, gëzimi i besimit të komuniteteve lokale, maksimizimi i shanseve të fëmijëve dhe të rinjve lokalë, kontributi për mirëqenien dhe bashkimin efektiv të zonës lokale dhe përfitimi nga lidhjet potenciale përgjatë kryeqytetit. Ne kemi ndërmend të rrisim standardet më tej dhe të sigurojmë përfshirjen e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve tanë. Ne besojmë që ata meritojnë asgjë më pak.”

Për të realizuar këtë vizion ne riafirmojmë dedikimin dhe vendosmërinë tonë për të punuar më shumë në krijimin e partneritetit të fortë me të gjithë ata në komunitet që kanë ndikim në të ardhmen e fëmijëve dhe të rinjve.

Mbi të gjitha ne duam që:

- përfundimisht të thyejmë lidhjen ndërmjet kushteve jo të mira të jetës dhe arritjeve të dobëta në mënyrë që të krijojmë komunitete të begatshme, përfshirëse dhe të qëndrueshme për shekullin e 21-të;
- të mbështesim shkollat sekondare që të arrijnë standardet më të larta, të jenë tërësisht përfshirëse, të venë aspiratat dhe arritjet e nxënësve në rend të parë dhe të kontribuojmë për bashkimin efektiv të komunitetit dhe për barazinë racore;
- të transformojmë arritjet për individë dhe grupe të lëndueshme;
- të mundësojmë shkollave sekondare që të kenë një rol kyç në rigjenerimin e lagjes dhe në agjendë më të gjerë që mbështet mirëqenien e të rinjve;
- të ndihmojmë të gjithë partnerët tanë me ndikim në të ardhmen e të rinjve që të punojmë bashkë për të dhënë shanset më të mira që të jetë e mundur për të rinjtë; dhe
- të investojmë në shërbime që mbështesin të rinjtë.

Ardhmëritë e Ndrishme organizohet rreth pesë pjesëve të cilat të gjitha kontribuojnë në ndryshime transformuese.

Shtylla 1: Të Rinjtë në Haringej

Ne njohim dhe përkrahim **llojlojshmërinë, arritjet dhe përfshirjen e të rinjve të Haringejit** por gjithashtu njohim **sfidat për ta të rriten në këtë rreth të llojlojshëm në kryeqytet**. Ne synojmë të planifikojmë për të ardhmen duke u mundësuar të rinjve që të **rrisin aspiratat e tyre dhe të përmirësojnë arritjet e tyre**.

Ne gjithashtu përqipemi që të **përkrahim zërin e të rinjve**, t'i inkurajojmë ata që të bëhen **qytetarë aktivë**, të inkadruar në marrjen e vendimeve dhe në kontributin pozitiv për shoqërinë.

Rezultatet

- Nëpërmjet Partneritetit Strategjik të Fëmijëve dhe të të Rinjve, të sigurojmë që shërbimet të mundësojnë që të rinjtë të jenë të shëndetshëm, të jenë të sigurt, të kënaqen dhe të arrijnë, të bëjnë kontribut pozitiv dhe të arrijnë mirëqenien ekonomike. Në veçanti, nëpërmjet Bordit të Fëmijëve lokal për mbrojtje, të sigurojmë që të rinjtë të ndjehen të sigurt në shkollë.
- Të dëgjojmë pikëpamjet e të rinjve për të siguruar që të konstruktojmë shërbimet tona rreth nevojave të tyre, për t'ju ndihmuar atyre që të arrijnë ambiciet e tyre dhe të ndjehen të mbrojtur dhe të sigurt.
- Të formojmë Parlamentin e të Rinjve dhe të zgjedhim Kryebashkiakun e Ri për të nxitur shanse për të rinjtë që të bëjnë kontribut pozitiv për shoqërinë.
- Të zhvillojmë partneritet të fortë për të mbajtur dhe përmirësuar shanset për të rinjtë dhe për të ofruar lehtësira/pajisje speciale më të mirat.
- Të përmirësojmë qasjen e të rinjve për informata, këshilla dhe udhëzime të pavarura.
- Të investojmë në Shërbimin e të Rinjve Haringej në mënyrë që të forcohen ofertat e tij për të rinjtë.
- Të rrisim ndjeshëm qasjen e të rinjve në TIK (Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit - kompjuterë) ashtu që të kenë fleksibilitet më të madh se si mësojnë dhe të kenë qasje në një rang të gjerë informatash për t'u ndihmuar atyre të bëjnë vendime të mençura.
- Të zhvillojmë shanse për të rinjtë në arte dhe sporte ashtu që të mund të përfitojë tërësisht nga shanset e hapura për ta në kryeqytet.

Shtylla 2: Mësimi dhe Mësimdhënia në Haringej

Ne duam të krijojmë një **planprogram entuziast** që frymëzon të rinjtë që të jenë nxënës kureshtarë dhe të vetë motivuar, që duan të dinë dhe të arrijnë më shumë, dhe të kenë burimet për ta drejtuar mësimin e tyre.

Për më tepër, ne duam që të zhvillojmë një forcë pune me **motivim të lartë dhe të kualifikuar mirë** që frymëzon të rinjtë, që ndërton mbi kreativitetin e tyre dhe që nxit mësimin e tyre.

Rezultatet

- Të vëmë të rinjtë e Haringejit në ballë të transformimit të mësimin duke i plotësuar nevojat e tyre të larmishme nëpërmjet një varg qasjesh të reja, përfshirë dhe rritjen e ndjeshme të përdorimit të TIK (*ICT* – kompjuterëve) nga ana e tyre.
- Të zgjerojmë punën e re të filluar në tranzicionin efektiv ndërmjet fazave primare dhe sekondare, për të siguruar që të gjithë të rinjtë të bëjnë progres të shkëlqyer në vitet e hershme të shkollave sekondare.
- Të zgjerojmë fleksibilitetet e planprogramit në fazat kyçe 4 deri te faza kyçe 3, posaçërisht për të rinjtë në rrezik të nën-arritjeve dhe për të mundësuar një hyrje të hershme dhe njohje për nxënës me arritje më të mëdha.
- Të zgjerohet ndjeshëm rangi i rrugëve dhe vendeve për edukim dhe trajnim për 14 – 19 vjeçarët, ashtu që më shumë të rinj të inspirohen nga çfarë po mësojnë dhe të jenë entuziastë për të vazhduar edukimin pas 16 vjetësh, apo të sigurojnë një trajnim apo punësim të shpërblyeshëm.
- Nëpërmjet shkollimit të zgjatur, të sigurohen më shumë orë qasje në mësim, posaçërisht për ata të rinj me burime të kufizuara në shtëpi.
- Përdorimi i Sporteve dhe Arteve për të drejtuar dhe mbajtur interesin në trajnim zanatesh, brenda programit më të gjerë të mundësive të shtyrë nga Lojërat Olimpike dhe Paraolimpike 2012.
- Themelimi i Haringejit si qendër e shkëlqimit për rekrutim, mbajtje dhe zhvillim profesional të tërë stafit, me ekip shembull profesionistësh në secilën shkollë që nxit dhe jep shembull të pasionit për shkëlqim në mësim dhe mësimdhënie.
- Përdorimi i TIK (*ICT*) për të transformuar mësimin dhe mësimdhënien.

Shtylla 3: Udhëheqës Haringeji

Ne duam të krijojmë **udhëheqës të klasit botëror** që kanë **ndjenjë të thellë të qëllimit moral**, në gjendje të zhvillojnë **rol komuniteti** përtej kufijve të shkollës dhe të cilët mund të drejtojnë me **stil kolegjal** që mundëson të tjerët dhe që **ndërton partneritete të forta**.

Rezultatet

- Të themelohet Haringeji si qendër shkëlqimi në zhvillimin e drejtimit në shkollë.
- Të themelohet drejtim i fortë komuniteti që ka rol të qartë në nxitjen e bashkimit efektiv të komunitetit dhe të barazisë racore.
- Forcimi i vetë-vlerësimit të shkollës dhe rishqyrtimit të bashkëmoshatarëve, ashtu që drejtuesit e të gjitha niveleve të kenë fokus të fortë në progresin e secilit të ri dhe se si po plotësohen nevojat e tyre.
- Të krijohet një Forum 11–19 për të siguruar përgjegjshmëri për të gjithë ata me ndikim në të ardhmen e të rinjve në Haringej.
- Të transformohet mënyra se si TIK përdoret për të mbështetur menaxhimin shkollor, për tu inkuadruar me komunitetin lokal dhe me botën më gjerë.

Shtylla 4: Prindër dhe Komunitet Haringeji

Ne duam që të nxisim **partneritetin me prindër/kujdesës** në edukimin e suksesshëm të të rinjve dhe të krijojmë **marrëdhënie të forta pune me komunitetet lokale** dhe me organizatat e tyre.

Rezultatet

- Mbështetja e prindërve që të bëhen vendim marrës, nxënës dhe dhënës të edukimit dhe guvernatorë (drejtues shkollash).
- Të mbahet dhe të ndërtohet mbi praktikat më efektive për të nxitur inkuadrimin e prindërve në shkolla.
- Nxitja e mësimit familjar dhe të të rriturve nëpërmjet mësimi pas shkollës.
- Inkuadrimi i prindërve në një numër forumesh ashtu që të mund të kontribuojnë në vlerësimin e shërbimeve tona, përfshirë shkollat, dhe ndihma për të siguruar që ne po plotësojmë nevojat e fëmijëve të tyre.
- Mbështetje dhe mundësim i punës së shkollave suplementare dhe të gjuhëve të komunitetit, përfshirë dhe përfaqësimin e tyre në Forumin 11-19.
- Sigurimi që të gjithë të rinjtë dhe familjet e tyre kanë qasje në kualitet të lartë informatash, këshillash dhe udhëzimesh të pavarura, përfshirë këshillë karriere për të mundësuar të rinjtë që të bëjnë zgjedhje të mençura mbi rrugët e tyre të edukimit dhe punësimit.
- Forcimi i qasjes së prindërve dhe komunitetit në mësim duke zhvilluar shërbime të mësimi pas orarit shkollor në secilën shkollë.

Shtylla 5: Shkollë Haringeji

Ne duam që të vazhdojmë të zhvillojmë **infrastrukturën, organizimin dhe zhvillimin** e shkollave ashtu që të mund të mbështesin mënyrat e ndryshueshme të **mësimit në Shekullin 21**.

Rezultatet

- Ndërtimi i një qendre të re të formës së gjashtë (*sixth form*) në lindje të rrethit deri në Shtator 2007.
- Bërja e një investimi të hershëm dhe të ndjeshëm për të transformuar sigurimin dhe përdorimin e TKI (*ICT*).
- Mundësimi i secilës shkollë sekondare që të ofrojnë shërbime pas shkollës.
- Reduktimi i formave të hyrjes në shkollat në lindje të rrethit ashtu që ata më mirë të plotësojnë nevojat komplekse të të rinjve që i shërbejnë.
- Të fillojmë duke zhvilluar shkollat 'çelës për sukses' dhe të krijojmë një kompleks mësimi përfshirës.
- Inkuadrimi i të gjitha shkollave në fazat e mëvonshme të programit BSF (*Building Schools for the Future – Krijimi i Shkollave për të Ardhmen*).
- Ndërtimi i një shkolle të re që hapet në Shtator 2009 me nxënës të vitit 7.
- Përfshirja e të gjitha shkollave speciale me shkollat sekondare të rrymës kryesore deri më 2008.
- Formimi i sigurimit të burimeve të ngjitur me shkolla sekondare për nxënës që kanë çrregullim të spektrit të autizmit.
- Përmirësimi i ambientit mësimor në shkolla sekondare që mbështesin nxënësit e verbër apo pjesërisht të verbër.
- Krijimi i njësisve mbështetëse në vend në shkollat sekondare për të mundësuar më shumë nxënës me vështirësi sociale, emocionale dhe sjelljeje (SEBD) për të marrë ndihmë multi-agjencish.
- Zhvillimi i masave jashtë vendit (shkollave) për nxënës që kanë SEBD të rëndë dhe komplekse për të dhënë shërbime me specializim të lartë për një numër më të vogël nxënësish.
- Rritja e numrit dhe rangut të specialistëve në shkollat sekondare të Haringejit, me lehtësira/pajisje të ndara me shkolla të tjera.
- Krijimi i deri në dy shkolla trajnimi për të dhënë trajnim fillestar mësimdhënësish dhe për të zhvillim të vazhdueshëm profesional.
- Hapja e një qendre të re të rinjsh dhe një qendër për çmimin Duka i Edinburgut.

Për të mbështetur këto pesë shtylla ne kemi detajuar plane për këto drejtime të rregullave dhe praktikave:

- Niveleve të tanishme të arritjeve dhe objektivave
- Përshtatja e planprogramit me nevojat e të rinjve
- Luftimi i rezultateve të dobëta
- Çdo Fëmijë ka Rëndësi: Ndryshime për Fëmijë
- Përfshirja
- Llojllojshmëria e masave shkollore
- Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
- Rimodelimi i fuqisë punëtore dhe Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (CPD)
- Kapaciteti i udhëheqjes në Haringej
- Treguesit e arritjeve, monitorimi dhe vlerësimi

Haringeji ka një vizion dhe drejtim të qartë, udhëheqje të fortë dhe partnerë të dedikuar. Ne kemi caktuar një agjendë ambicioze për ndryshime. Ne kemi vendosmërinë dhe zotimin për të arritur aspiratat tona, ashtu që të heqim barrierat për nën arritjet dhe të transformojmë rezultatet për fëmijët dhe të rinjtë që ne u shërbejmë.

Kopje të kësaj përmbledhjeje dhe/ose botimi i plotë mund të merren nga:

Wendy Quildan ose Thelma Austin
General Office
1st Floor
48 Station Road
Wood Green N22 7TY

020 8489 3893 / 3238

ose email: wendy.quildan@haringey.gov.uk or thelma.austin@haringey.gov.uk

www.haringey.gov.uk/brightfutures

Shërbimi i Fëmijëve
Dhjetor 2005

© Haringey Council 2005